



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 03 prill 2013, në orën 10:00, salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti.

Të ftuar: Ministri i Administratës Publike z. Mahir Yagcilar, Zv. Ministri i Financave z. Ramadan Avdiu, drejtori i departamenti të Thesarit z. Fatmir Plakiqi dhe Lars Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2013,
3. Diskutim rreth sistemit të menaxhimit të pasurisë,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2013

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se zëvendësministri i Financave z.Avdiu, ka informuar për pamundësinë e pjesëmarrjes në mbledhje dhe ka propozuar që mbledhja të shtyhet për një ditë tjetër. Meqenëse takimi më tepër është konsultativ, propozoi që mbledhja të mbahet dhe pa praninë e zëvendësministrit.

Ramiz Lladrovci – Tha se meqenëse takimi i sotëm për nga natyra është takim konsultativ u pajtua që të vazhdon takimi për shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës, në të kundërtën pa pjesëmarrjen e zëvendës Ministrit të Financave ky takim nuk do të ishte mbajtur.

3. Diskutimi rreth sistemit të menaxhimit të pasurisë

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit me historiatin e modulit të E-pasurisë dhe të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK). Që nga viti 1999 menjëherë pas përfundimit të Luftës në Kosovë, faktori ndërkombëtar në kontest të krijimit të një baze të të dhënave, ka siguruar një sistem Kanadez (Free Balanca) për menaxhimin e financave në Kosovë, nën administrimin e shtyllës së katërt të UNMIK-ut. Fillimisht sistemi kishte vetëm modulën e regjistrimit të Buxhetit dhe Shpenzimeve, më pastaj është vazhduar me module të tjera si me modulën e zotimeve, modulën e regjistrimit të pasurisë, moduli i blerjeve, moduli i të hyrave etj. Ministria e Financave, me departamentin e thesarit qysh në vitin 2009 ka përgatitur një bazë juridike „Udhëzimin Administrativ 21/2009” mbi regjistrimin e pasurisë. Ishte kjo nevojë e institucioneve dhe obligimi ligjor që pasuria të paraqitet në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF). Përmes Udhëzimit Administrativ 21/2009 mbi regjistrimin e pasurisë të Ministrisë së Financave ju është mundësuar të gjitha organizatave buxhetore që të kenë një pozitë pune “zyrtar i pasurisë”, që do të regjistron në sistem të Free Balancës në modulën e regjistrimit të pasurisë, të gjithë pasurinë (asetet) e institucionit e që vlera e asaj pasurie për njësi është me e lartë se 1 mijë euro. Po ashtu, sistemi në mënyrë automatike llogaritë amortizimit gjegjësisht zbaton normat e zhvleftësisë të pasurisë. Mirëpo, përmes këtij moduli zyrtarët e pasurisë nuk kanë mundur të regjistrojnë pasurinë e cila ka pasur vlerë me të vogël se 1 mijë euro si dhe nuk është mundësuar të regjistrohet pasuria edhe sipas kontabilitetit material.

Sistemi “E-pasuria” është në pronësi të MAP-it. Ky është një sistem i integruar elektronik përmes të cilit institucionet kanë mundësinë të trajtojnë të gjitha pasuritë e tyre brenda organizatës. Ky sistem shërben si mbështetje për menaxhim efektiv të pasurisë së institucioneve. Ai mirëmban të dhënat e sakta me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre. Mundëson menaxhimin dhe monitorimin e gjendjes së stokut, minimizimin ose eliminimin e stokeve nëpër depot e institucioneve. Efekti i këtij është se përdoruesit duhet të fusin të dhënat ndaras në të dy sistemet. Kjo në vete përbën arsye për gabime. ZAP ka rekomanduar ndërmarrjen e masave në lidhje me këtë dhe deri më tani asgjë nuk është bërë. Moduli i zhvlerësimit nuk funksionon, edhe përkundër përpjekjeve për ta zgjidhur këtë problem. ZAP ka vërejtur dobësi në raportim të vlerës së pasurisë. Deri në një masë të caktuar, këto dobësi kanë ndodhur për shkak të dizajnit të sistemit “E-pasuria”. Në institucionet buxhetore, ka defekte të shumta në regjistrimin e pasurisë. Kjo është vërejtur në Auditimet e ZAP-it në Pasqyrat Vjetore Financiare të institucioneve buxhetore. Në përgjithësi vërejtjet e auditorit në shumicën e rasteve janë se institucionet buxhetore nuk kanë një pasqyrë të sakët të regjistrimit të pasurisë, dhe se ekzistojnë mosbarazime në mes modulit të regjistrimit të pasurisë në Free Balanc dhe në E-pasuri. Komisioni për mbikëqyrje të financave publike gjatë analizimit të raporteve të auditimit të institucioneve buxhetore ka vërejtur se në shumicën e rasteve rekomandimet e ZAP-it kanë ardhur si rezultat i një pasqyrimi jo të sakët të pasurisë së këtyre institucioneve të audituara. Komision është i orientuar të kemi një sistem unik dhe në

harmoni të plot me standardet e kontabilitetit.

Artan Venhari, zëvendësauditor – ZAP ka mirëpritur këtë hap të KMFP për diskutimin e kësaj çështjeje. Vërejtjet – të gjeturat e ZAP-it lidhur me sistemet janë dhënë në raportet e auditimit për institucionet buxhetore të audituara. Në përgjithësi vërejtjet e auditorit në shumicën e rasteve janë se institucionet buxhetore nuk kanë një pasqyrë të sakët të regjistrimit të pasurisë.

Ibrahim Gjylideron, ZAP - Ne jemi të mendimit që të ketë unifikim të këtyre dy sistemeve me kusht të jenë me lehtë të menaxhueshme, kjo për faktin se ekzistojnë dy sisteme dhe mundësit për gabime në regjistrim të të dhënave në këto dy sisteme janë të mëdha. Kjo më së miri është vërejtur në auditimet e bëra nga ZAP.

Mahir Yagcilar - E-pasuria ka filluar se funksionuari në bazë të LMFP dhe udhëzimit administrativ të Ministrisë së Financave, si dhe një vendimi të Qeverisë për funksionalizimin e sistemit të E-pasurisë. Ky sistem mundëson mirëmbajtjen e të dhënave me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre. Mundëson menaxhimin dhe monitorimin e gjendjes së stokut, minimizimin ose eliminimin e stoqeve nëpër depot e institucioneve, mbështet vendosjen e barkodeve në inventar të regjistrimit të pasurisë, mundëson aplikimin e normave të amortizimit, mundëson po ashtu të gjeneroj raporte të ndryshme. Ky sistem hynë në grupin e projekteve për qeverisje elektronike. Sistemi është i dizajnuar që klientët të kyçen nga interneti. Sistemi mundëson menaxhimin e pasurive kapitale si dhe atyre jo kapitale. Në këtë sistem kanë qasje edhe auditorët e brendshëm në institucionet ku punojnë, po ashtu në këtë sistem kanë qasje edhe auditorët e jashtëm për t'i parë shënimet në këtë sistem por jo edhe për të futur të dhënat. Sistemi ka filluar së funksionari në vitin 2009, për këtë ekzistojnë edhe statistikët për vite. Problem në vete paraqitet numri i stafit, ku sipas udhëzimit thuhet se secila organizatë buxhetore duhet ta ketë zyrtarin e pasurisë, në disa raste kjo nuk po mund të realizohet për shkak të kufizimeve të numrit të punëtorëve. Të gjitha këto kanë të bëjnë me aspektin teknik të funksionimit të këtij sistemi, ndërsa sa i përket aspektit legjislativ jam i gatshëm të kontribuoj për ndryshime.

Fatmir Plakiqi – Theksoi se Thesari punon me sistemin e menaxhimit financiar informativ. Ky sistem ka hyrë në funksion prej vitit 1999-2000 dhe që nga viti i 2006 e ka të integruar edhe modulën e menaxhimit të pasurisë, regjistrimin e pasurisë. Të gjitha organizatat buxhetore kanë qasje në këtë modul dhe ne kemi trajnuar më së 200 zyrtar të të gjithë organizatave buxhetore. Aktualisht në sistem janë përdorues aktiv 136 përdorues. Ky modul mandej është mbështet edhe nga një udhëzim administrativ numër 21/2009 që jep shpjegime më të përgjithshme në menaxhimin e pasqyrave qeveritare, sistemi siç e cekëm kalkulon në mënyra automatike norma të amortizimit vjetor. Thesari thuhet se është pronari i sistemit të modulit të regjistrimit të pasurisë, ne jemi në bashkëpunuar në këtë aspekt dhe do të shohim se si do të mund të gjejmë zgjedhje më të mirë të mundshme. Në Thesar janë të përcaktuara që regjistrimi të bëhet mbi vlerën 1 mijë euro. Kjo për shkak se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në ato kode ekonomike se shpenzimet mbi 1 mijë euro konsiderohen të jenë kapitale dhe për atë arsye ne i kemi kufizuar regjistrimet deri në këtë shumë. Regjistrat nën këtë shumë do t'i kenë regjistrat e vet secila organizatë buxhetore për mbajtjen e kontrollit të E-pasurive.

Ramiz Lladrovci - Qëllimi ynë është që të bashkëbisedojmë për një mundësi të harmonizimit të Free Balancit dhe të sistemit të E-pasurisë. Ministri nuk na dha një propozim se si mund të kemi bashkëpunimin që këto dy sisteme të veprojnë si një sistem. Pyeti: si mendoni zgjidhjen e këtij problemi, cili është mendimi juaj lidhur me këtë çështje?

Zilif Lufi – Sistemet si të tilla kanë nevojë të avancohen si në teknologji po ashtu edhe në burime njerëzore, koha kur është filluar me këto sisteme ishte viti 2006 fillimisht me Free Balanc, e më pastaj në vitin 2009 edhe me sistemet E-pasurinë. Nëse pyetem se a je i kënaqur

me funksionimin e këtyre sistemeve, natyrisht se them jo. A jam për modifikimin e këtyre sistemeve them se po, mirëpo sistemi është vetëm një vegël përmes së ciles nuk mund të zgjidhet i tërë problemi. Sipas standardeve edhe me procese buxhetore është kategorizuar buxheti kapital dhe atë është thënë çmimi për njësi prej 1 mije euro dhe afati i qëndrueshmërisë me i gjatë se një vit është trajtuar si kapital dhe kjo është futur në sistem të Free Balances dhe ka ndodhur duke filluar nga viti 2006. Në ndërkohë Qeveria nxori një vendim dhe e autorizoi Ministrinë e Administratës Publike që të krijoj mundësinë që në sistem të regjistrohet pasuri nën vlerën 1 mije euro, me pastaj në vitin 2009 MF nxori Udhëzimin Administrativ 21/2009 mbi regjistrimin e pasurisë. Ne po ashtu edhe tani kemi shkëmbim të informatave me MAP-in gjegjësisht me sistemin e E-pasurisë, dhe se vlerat më të larta se 1 mije euro i kemi afruar sistemit të E-pasurisë mirëpo, kjo ka paraqitur dyshime se mund të ketë defekte në vet sistemin. Kjo ka paraqitur probleme të shumta për organizatën buxhetore në veçanti në hartimin e PVF.

Mahir Yagcilar - Aktualisht jemi vetëm në zbatim të një baze juridike që na u është dhënë me herët, dhe nëse kjo mendohet ndryshe ne jemi në pozicion të marrim përgjegjësi apo t'i japim ato. Të hartohet baza e re ligjor dhe si mendohet të ecet me tutje, të jenë dy sisteme kompetabile apo të fuzionohen vetëm në një sistem.

Mursel Halilji – Krijimi i bazës ligjore është i domosdoshëm. Edhe pse për momentin ekziston një udhëzim administrativ për regjistrimin e pasurisë. Pyeti: kur do të fillohet të merren veprime konkrete për modifikim të këtyre sistemeve? Po ashtu edhe MF dha argumente të mjaftueshme për funksionimin e sistemit të Free Balances. Komisionit fillimisht i duhet të ketë një baze ligjore mbi modifikimin e këtyre sistemeve. Po ashtu të fillohet me modifikim të tyre, sepse sistemet kanë ekzistuar, mirëpo nuk kanë dhënë ndonjë performancë të mirë në regjistrimin e pasurisë. Kjo është thënë në raportet e auditimit në institucionet e audituara.

Kryetari – Ishte i mendimit të formohet një trup prej subjekteve të ndryshëm me emra konkret dhe me afate konkrete, që do ta trajtoj çështjen dhe do të vij para këtij Komisioni në këtë përmbajtje.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni mund të rekomandoj, por nuk ka të drejtë t'i obligoj të krijojnë grupe. Rekomandimi për formimin e një trupi punues mund të jetë. Pjesë e këtij mund të jenë tri subjektet kryesore për të gjetur një zgjidhje. Komisioni mund ta afatizoj në kohë ndërmarrjen e veprimeve, dhe raportimin në Komision.

Fatmir Plakiqi – Ne do të punojmë së bashku me secili institucion, po ashtu do t'i ofrojmë emrat përfaqësuesve të thesarit. Mendojë se MAP-i duhet të udhëheq këtë proces dhe një kohë relativisht të shkurt Komisioni ta ketë një raport lidhur me veprimet e ndërmarra.

Valbona Dibra – Propozoi që rekomandimit të Komisionit t'i shtohet edhe rekomandimi për krijimin e bazës ligjore për këtë çështje, sepse pjesa tjetër pastaj është teknike.

Kryetari – Ishte i mendimi që kjo çështje duhet të kryhet para se Kuvendi të shkoj në pushim. Grupi punues do të jete i përberë nga 2 përfaqësues të Thesarit - MF, 2 përfaqësues të MAP-it dhe 1 përfaqësues nga ZAP. Presim që ky grup punues për çdo muaj të raportoj në Komision lidhur me progresin e arritur.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- 1. Të formohet një trup punues në mes të Ministrisë së Administratës Publike (dy anëtarë), Ministrisë së Financave (dy anëtarë) dhe Zyrës së Auditorit të**

Përgjithshëm (një anëtarë), për të trajtuar dhe zgjidhur çështjen e sistemit të menaxhimit të pasurisë dhe për hartimin e bazës ligjore për të rregulluar këtë çështje.

- 2. Ky trup punues do të gjejë modalitetet nëse sistemi i Free Balanc dhe E-Pasurisë do të shkrihen në një sistem unik apo do të adaptohen këto dy sisteme në mënyrë që të jenë kompatible njëra me tjetrën.**
- 3. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm do të ndihmojë këtë trup punues për adresimin e saktë të kësaj çështjeje.**
- 4. Të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me sistemin e menaxhimit të pasurisë, duhet të zgjidhen para se Kuvendi të shkojë në pushim të sesionit pranverorë.**
- 5. Ky grup punues në baza kohore - një herë në muaj - do të njoftoj Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e këtij problemi.**

4. Të ndryshme

Vlbona Dibra – Propozoi që Komisioni të merret me shqyrtimin e propozimit të saj që ka bërë në mbledhjen e fundit, lidhur me kërkesën për raport nga ZAP për menaxhimin stafit në këtë institucion.

Kryetari – Ishte i mendimit që pika të ndryshme të mos hapet për diskutim, meqenëse Komisioni në rend dite ka pasur një takim më tepër konsultativ. Çështje të cilat do të ngriten në pikën të ndryshme duhet t'i paralajmërohen kryetarit të Komisionit. Komisioni nuk mund të hyjë në çështje të cilat nuk i takojnë. ZAP është i pavarur dhe pavarësia e tij është kategori kushtetuese. Prononcimi i deputetes Dibra në media, ka dal jashtë përgjegjësisë të anëtarëve të Komisionit. Çështja për të cilën doni të debatoni duhet të trajtohet në mekanizma të tjerë institucional. Komisioni ka angazhuar kompani auditimi për ZAP-in dhe pasi që Komisioni të marr raportin e auditimit mund të dali me rekomandime konkrete.

Valbona Dibra - Mos hapja e pikës të ndryshme për diskutim është thyerje e rregullave të Komisionit. Kjo është cenim i të drejtave të anëtarit të Komisionit. Në tri takimet e fundit kryetari i Komisionit insiston që pika të ndryshme të mos hapet për diskutim. Çështja e ngritur nuk cenon pavarësinë e ZAP. Po kërkoj raport nga ZAP për keq menaxhimin e stafit. Fjala është për një letër që sindikata e ZAP-it i ka dërguar menaxhmentit. Si Komision duhet të kemi informata se si është trajtuar shqetësimi i stafit. Deputeti ka të drejtë të flas dhe kam folur në emrin tim personal si anëtare e Komisionit në asnjë mënyrë në emër të Komisionit. Propozimin tim duhet ta votojë. Komisioni në vazhdimësi ka kërkuar raporte të performancës. Nëse jemi real dhe kemi qëllim që ajo zyre të fuqizohet, ne duhet ta monitorojmë se si po menaxhohet ajo zyrë. Punëtorët e trajnuar për performancë a janë pozicionuar në departamente përkatëse? ZAP ka dorëzuar vetëm dy raporte të performancës. Nuk kam asnjë tendencë, por jam në mbrojtje të punëtorëve. Kjo çështje është dashur të ngritet nga opozita. Krejt çka po kërkoj nga Komisioni është që të votoi propozimin tim për kërkesë për raport nga ZAP, bashkë me letrën e sindikatës drejtuar menaxhmentit të cilën pastaj Komisioni do ta shqyrtoj në mbledhje. Nuk është problemi i rekrutimit të stafit, nuk ndërhyjmë në çështjen se si e ka rekrutuar stafin p.sh rekrutimi i zëvendësauditorit me vetëm dy persona në panel, por kam kërkuar raport për menaxhimin e stafit aktual, keqtrajtimin e tyre. Nuk është hera e parë që Komisioni kërkon raport nga ZAP. Këtë e kemi bërë para një viti kur është kërkuar nga Komisioni raport për riorganizimin e ZAP-it.

Kryetari – Si kryetar i Komisionit duhet të marrë mendimin anëtareve të Komisionit. Diskutimi i tanishëm është i papërgatitur. Këtë çështje do ta trajtojmë në mënyrë të drejtë. Politikë në këtë Komision nuk lejoj që të bëhet. Kur hapa mbledhjen e Komisionit u pajtuam që kjo mbledhje, meqenëse ishte e tipit konsultativ, ne pranuan madje të diskutojmë për pikën e rendit të ditës edhe pa praninë e ministrit. Propozimi i deputetes ka pas për tu diskutuar në mbledhjen e radhës. Komisioni duhet të jetë i vëmendshëm për punën, sepse objekt i punës së Komisionit është shqyrtimi i raporteve, prandaj duhet të presim raportin e auditimit. Me debatin në këtë kohë në këtë Komision mund të ndikojmë në punë e auditorit që do të bëjë auditimin e ZAP-it. Ligji për ZAP, është diskutuar disa herë dhe jemi pajtuar që MF-ja të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e këtij Ligji. Prandaj për atë projekt nuk mund të ngarkohet ZAP. Për draftin kam dhënë vërejtje personalisht. Objekt diskutimi nuk duhet as nuk mund të jetë ajo çka shkruhet në shtyp. Kjo është ndërhyrje në punën e një institucioni të pavarur. Kjo çështje është politizuar. Nuk kam informacione nëse ka pasur ndërhyrje në punë e ZAP-it, përveç deklaratave të deputetes Dibra. Me atë rast është përmendur edhe deputeti Ramiz Lladrovci por ky është sqaruar. Komisioni kërkesat për raporte nga institucionet duhet t'i bëjë përmes Kuvendit.

Ramiz Lladrovci – Kryetari ka propozuar agjendën të cilën e miratoi Komisioni. Deputetët kanë të drejtë të flasin çka të duan dhe për atë mbajnë përgjegjësi. Askush nuk ka ndërhyrë në pavarësinë e ZAP-it, por ZAP i raporton Kuvendit të Kosovës dhe atë përmes Komisionit. Prandaj, duhet të raportohet edhe për problemet eventuale në këtë Zyrë. Kryetari disa herë e ngriti çështjen se Komisioni nuk duhet të merret me atë çka shkruajnë mediat. Pikërisht është kryetari ai i cili më së shumti flet çka kanë thënë gazetatat, se sa rreth asaj se çka përmban raporti i caktuar. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të flasin çka të duan. Është diçka tjetër pastaj a është më kredibile nëse flitet për diçka çka flitet në media apo çka shqyrtohet në raporte. Komisioni nuk ka asnjë pengesë që të kërkoj një raport lidhur me shqetësimet dhe problemet e brendshme të stafit. Kjo nuk duhet të debatohet aq shumë. Le të votohet propozimi dhe kjo varet nga rezultati i votimit.

Personalisht nuk kam nevojë të sqarohem para askujt. Mediat e kanë përdorur procesverbalin e mbledhjes i cili është votuar në këtë Komision dhe është publikuar. Nuk ka nevojë të debatohet kjo çështje. Propozimi i deputetes duhet të votohet, pastaj është çështje tjetër që raporti i ZAP-it mund të jetë i mirë. Nëse kryetari thotë se Komisioni nuk ka të drejtë ta kërkoj këtë raport, atëherë le të na tregoj se në bazë të cilit Ligj apo nen është paraparë kjo.

Bali Muharremaj - Ishte i mendimit që deputetët kanë të drejtë të marrin fjalën për çdo çështje. Ishte i mendimit që të presim raportin e kompanisë audituese. Propozoi që propozimi i deputetes të dalë në votim edhe pse personalisht ishte kundër këtij propozimi. Megjithatë tha jam i mendimi që Komisioni të pres Raportin, pastaj të kërkojë një informatë nga ZAP.

Afrim Hoti - Deputetja Dibra është dashur ta njoftoj Komisionin lidhur me çështjen, në mënyrë që anëtarët e Komisionit të jenë të informuar dhe të përgatitur. Ishte i mendimit që Komisioni të pres raportin e auditimit dhe të debatohet lidhur me të.

Albert Kinolli – Komisioni ka një përfundim nga mbledhja e kaluar ku është vendosur që të diskutohet sot në këtë mbledhje, propozimi i deputetes. Materiali nga mbledhja e kaluar është transparent dhe bazuar në këtë anëtarët e Komisionit janë të informuar për çështjen të cilën e ka kërkuar deputetja Dibra. Nuk mund të themi që nuk kemi pasur informata për çështjen e deputetes.

Mursel Haljilji - Nëse nuk merremi me propozimi i deputetes Dibra atëherë ne shkelim vendimin Komisionit. Por, personalisht nuk kam të dhëna për çështjen që do të debatohet. Përkrah çështjen të cilën do ta ngris deputetja, por ekzistojnë procedurat të cilat duhet respektuar. Ndoshta lidhur me këtë sindikata e ZAP-it duhet tu drejtohet institucioneve të tjera, sepse kjo më tepër është çështje pune. Propozoi që Komisioni të debatohet lidhur me këtë në një

mbledhje tjetër.

Kryetari – Propozoi që Komisioni të kërkojë këshillë juridike nga Departamenti ligjor përkitazi me çështjen nëse Komisioni ka të drejtë apo jo të kërkojë raport nga ZAP për menaxhimin e stafit në këtë institucion. Kjo çështje nuk ka të bëjë me kompetencat e Komisionit. Kërkesat e Komisionit duhet të shkojnë përmes Kuvendit. Komisioni nuk mund të votojë për kompetencat të cilat nuk i ka.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nga gjithsejtë 7 deputet të pranishëm, me 6 vota për, një kundër, asnjë abstenim, nxori këtë

Përfundim

1. *Shqyrtimi i propozimit të deputetes Valbona Dibra, lidhur me kërkesën për raport nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm, rreth menaxhimit të stafit në këtë Institucion, bëhet në mbledhjen e radhës të Komisionit.*
2. *Kërkohet nga Administrata e Kuvendit, përkatësisht Departamenti Ligjor që të jap këshillë juridike lidhur me:*
 - *Nëse Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka apo nuk ka të drejtën që të kërkojë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, raport lidhur me menaxhimin e stafit në këtë institucion.*
 - *Nëse Komisioni ka të drejtën,, raporti nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, duhet të kërkohet përmes Kuvendit apo drejtpërdrejtë nga Komisioni.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu